

TK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 4483 Prot

Shkodër, më 5.3.2024

VENDIM

Nr. 268, datë 5.3.2024

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936 ,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” të ndryshuar; ligjit nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; Udhëzimi nr.30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, znj.Teuta Qyteza me detyrë zëvendeskryetare bashkisë Shkodër;
 - Për nënshkrimin e çdo shkresë që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/ fizik dhe individ për;

-Drejtorinë e Shërbimeve Sociale
2. Zv/kryetarja nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
3. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 06.03.2024 dhe përfundon me datë 28.06.2024.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet znj.Teuta Qyteza dhe administrata bashkisë Shkodër.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

Benet BECI

